



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:247429

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05676572

KE.nr. 868/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Podujevës, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi i borxhit në emër të qirasë, vlera e objektit të kontestit EUR 152,734.26, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 29.04.2024, në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 13.05.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Komuna e Podujevës, ashtu që; DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., që në emër të qirasë për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në sipërfaqe prej 510 m², sipas fletës poseduese 1230, ngastra kadastrale nr. 69, ZK Podujevë, sipas kontratës nr. 09-70/2002, e lidhur me datë 01.02.2001, për periudhën kohore prej datës 01.08.2010 deri më 13.04.2013, t'ia paguaj paditësit shumën prej EUR 33,828.84 (me shkronja: *tridhjetë e tremijë e tetëqind e njëzet e tetë Euro e tetëdhjetë e katër Cent*), me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në Kosovë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë, data 06.08.2013, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Komuna e Podujevës, mbi shumën e gjykuar si në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për pagesën e borxhit në emër të qirasë, sipas kontratës nr. 09-70/2002, e lidhur me datë 01.02.2001, për periudhën kohore prej 01.02.2001 deri më 31.07.2010, në shumë prej EUR 118,905.42.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Komuna e Podujevës, me datë 06.08.2013, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega Podujevë, ka paraqitur padi ndaj të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që në emër të pagesës së qirasë, paditësit t'ia paguaj shumën prej EUR 145,860.00, me kamatë ligjore deri në pagesën definitive.

Në padi paditësi ka theksuar se me të paditurën kanë lidhur kontratë për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës shoqërore në sipërfaqe prej 510 m², sipas fletës poseduese 1230, ngastra kadastrale nr. 69, ZK Podujevë, sipas së cilës kontratë e paditura ka qenë e obliguar që të paguaj në emër të qirasë mujore shumën prej EUR 2,040 DM (marka gjermane). Ndërsa, përkundër që paditësi ka kërkuar me datë 24.09.2012 pagesën e qirasë, e paditura nuk i ka kryer detyrimet e veta. Andaj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

E paditura Korporata Energjetike e Kosovës, në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetim se kërkesa e paditësit rrjedhë nga viti 2001, ndërsa padia për pagesën e borxhit është paraqitur me datë 06.08.2013, dhe si rezultat i kësaj kërkesa e paditësit është përfshi në parashkrim në kuptim të nenit 375 dhe 373 të LMD-së. Ndërsa, ka shtuar se kontrata mbi bazën e së cilës kërkohet pagesa e qirasë është nënshkruar nga punonjësi i paautorizuar i të paditurës dhe rrjedhimisht është kontestuese dhe e papranueshme për të paditurën. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega Podujevë, me Aktgjykimin C.nr. 334/13, të datës 10.09.2018, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që është detyruar e paditura që në emër të qirasë, paditësit t'ia paguaj shumën prej EUR 28,560.00 me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara mbi një vit në bankat komerciale pa destimin të caktuar, si dhe shumën prej EUR 400.00 në emër të shpenzimeve të procedurës kontesitmore, ndërsa përtej shumës së aprovuar, pjesën tjetër të kërkesëpadisë për pagesën e qirasë në shumë prej EUR 117,300.00 e ka refuzuar si të pabazuar.

Ndaj këtij aktgjykimi palët kanë paraqitur ankesë, ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 4/2022, të datës 20.07.2023, ka aprovuar ankesën e të paditurës si të bazuar, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega Podujevë C.nr. 334/2013, të datës 10.09.2018 e ka anuluar dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.

Në rivendosje, përfaqësuesi i paditësit në seancat e mbajtura dhe fjalën përfundimtare ka qëndruar në tërësi pranë kërkesëpadisë duke theksuar se mbi bazën e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës shoqërore e datës 01.02.2001, e paditura i ka mbetur borxh paditësit qiratë e papaguara. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të palës së paditur se kontrata është nënshkruar nga personi i paautorizuar, ka theksuar se e njëjta ka pasur mundësi që të parashtrij padi për anulimin e kësaj kontratë, mirëpo përkundër kësaj e paditura ka parashtruar padi në një procedurë tjetër për vërtetimin e pronësisë lidhur me ngastrën të cilën e ka shfrytëzuar, ndërsa gjykata kërkesën e tillë të të paditurës e ka refuzuar si të pabazuar. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që në emër të qirasë për periudhën kohore prej datës 01.02.2001 e deri më 13.04.2013, t'ia paguaj paditësit borxhin në lartësi prej EUR 152,734.00, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në Kosovë, mbi një vit pa destinim të caktuar, si dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë shumën prej EUR 200.00 në emër të ekspertizës financiare.

E paditura në seancat e mbajtura dhe fjalën përfundimtare ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se kontrata e pretenduar mes palëve është lidhur në vitin 2001, kurse padia është paraqitur në vitin 2013 dhe rrjedhimisht kërkesa e paditësit është parashkruar në kuptim të nenit 373 të LMD-së. Me tej, ka shtuar se kontrata mbi të cilën bazohet kërkesa e paditësit nuk ka efekte juridike dhe se e njëjta është e pavlefshme nga fakti se kjo kontratë është nënshkruar nga personi i cili nuk ka pasur autorizime që të nënshkruaj kontratë në emër të korporatës, përkatësisht të të paditurës. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor bëri administrimin e provave si në vijim: Pasqyrën e detyrimeve të të paditurës sipas kontratës së datës 01.01.2001-2012; Kontratën mbi dhënien e tokës në pronësi shoqërore për shfrytëzim të përkohshëm e datës 01.01.2001, me numër të protokollit 09-70-2002; Vendimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit nr. 09-52, i datës 01.07.2008; Fletë dorëzimet e lëshuara nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë pranë të paditurës; Konkluzionin mbi lejimin e ekzekutimit me dhunë të vendimit nr., 08-45, të datës 03.09.2010; Vendimin mbi caktimin e kompensimit të qirasë për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës ndërtimore nr. 09-52/2001, i datës 12.02.200; Vendimin e Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi për shkëputjen e kontratës për shfrytëzim të përkohshëm të

lokacionit në pronësi të Komunës, nr. 08/41, të datës 08.04.2013; Vendimi për caktimin e kompensimit të qirasë për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës shoqërore, nr. 09-143, të datës 12.11.2003, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/29, të datës 08.03.2011; Procesverbalin e seancës së datës 10.09.2018 mbi deklarin e dëshmitarëve B.F. dhe H.D.; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega Podujevë C.nr. 598/10, të datës 04.12.2015, si dhe; Ekspertizën financiare të datës 28.02.2024, e punuar nga eksperti gjyqësor R.F..

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Në rastin konkret, mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se e paditura ka qenë në shfrytëzim të sipërfaqes prej 510 m², ngastra kadastrale nr. 69, sipas fletës poseduese 1230, Zona Kadastrale Podujevë, deri më datë 13.04.2013, fakt ky që vërtetohet edhe nga Kontrata mbi dhënien e tokës në pronësi shoqërore në shfrytëzim e datës 01.02.2001, me numër të protokollit 09-70-2002, dëgjimi i dëshmitarëve B.F. e H.D., si dhe nga vet deklarinimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në seancat gjyqësore.

Megjithatë, kontestuese ishte vlefshmëria e kontratës së lidhur mes palëve për shkak të nënshkrimit nga personi i paautorizuar i të paditurës, si dhe parashkrimi i kërkesës së paditësit në kuptim të nenit 373 të LMD-së, nga fakti se kërkesat e paditësit burojnë nga viti 2001, ndërsa padia për pagesën e qirave sipas kontratës është paraqitur në vitin 2003.

Nga Kontrata mbi dhënien e tokës në pronësi shoqërore në shfrytëzim e datës 01.02.2001, me numër të protokollit 09-70-2002, e lidhur në afat të pacaktuar mes paditësit Komuna e Podujevës dhe të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm të paditurës tokën ndërtimore në sipërfaqe prej 510 m², sipas ngastrës kadastrale nr. 69, fleta poseduese 1230, ZK Podujevë, me qëllim të vendosjes së objektit të përkohshëm për ushtrimin e veprimtarisë. Ndërsa, e paditura ka marr për obligim që në emër të qirasë për shfrytëzimin e kësaj pronë, paditësit t'ia paguaj qiranë mujore në larësi prej EUR 2,040.00 DM, duke filluar prej datës 01.02.2001.

Nga Vendimi nr. 09-52/2001, i datës 12.02.2002, mbi caktimin e kompensimit të qirasë për shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore, rezulton se paditësi ka përcaktuar lartësinë e

detyrimin të të paditurës për periudhën kohore prej 01.02.2001 deri më 31.12.2001, në shumë të përgjithshme prej EUR 11,473.00.

Nga vendimi nr. 09-143, i datës 12.11.2003, i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në kuadër të paditëses, rezulton se qiraja për periudhën prej 01.01.2003 deri më 01.10.2003 është përcaktuar në lartësi prej EUR 13,770.00, ndërsa shuma e përgjithshme e borxhit të të paditurës arrin lartësinë prej EUR 48,960.00 tokës në pronësi të komunës.

Nga Vendimi i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në kuadër të Komunës së Podujevës, nr. 09-52, i datës 01.07.2008, rezulton se borxhi i të paditurës për shfrytëzimin e pronës sipas kontratës mes palëve, për periudhën kohore prej datës 01.02.2001 e deri më 30.06.2008 është në lartësi prej EUR 908.60.

Nga pasqyra e detyrimeve të të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës bë bazë të kontratës së datës 01.01.2001-2012, rezulton se detyrimi i të paditurës deri në muajin dhjetor të vitit 2012 ishte në lartësi prej EUR 145,860.00.

Nga fletë dorëzimet, rezulton se e paditura është njoftuar nga Drejtoria për Kadastër në kuadër të paditësit, për të gjitha pagesat e qerasë dhe njoftimet e tjera lidhur me kontratën e datës 01.02.2001, me numër të protokollit 09-70/2002.

Nga Vendimi nr. 08/41, lëshuar nga Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, i datës 08.04.2013, rezulton se paditësja ka shkëputur kontratën e lidhur me të paditurën për shfrytëzim të përkohshëm të pronës me numër të protokollit 09-70/2002 për shkëputjen e kontratës për shfrytëzimin e përkohshëm të ngastrës kadastrale nr. 69, në sipërfaqe prej 510 m², sipas fletës poseduese 1230, ZK Podujevë.

Sipas dëshmitarit B.F., ngastra kontestuese dhe objekti është diskutuar edhe me kryetrarin e komunës ku është përmendur qiraja, mirëpo që është kundërshtuar kërkesa për pagesën e qirasë duke konsideruar se pronar është e të paditurës KEK dhe jo e paditësit, këtu Komuna e Podujevës. Ndërsa, sa i përket nënshkrimit të kontratës për qiranë objekt kontesti në këtë çështje ka deklaruar se askush përveç drejtorit menaxhues të KEK nuk është kompetent për nënshkrimin e kontratave.

Ndërsa, dëshmitari H.D. ka deklaruar se ka qenë në njohuri se ka kontratë për qiranë të lidhur mes Kuvendit Komunal dhe një punëtori të KEK të cilin nuk e ka njohur, mirëpo që sipas dëshmitarit i njëjti nuk ka pasur autorizime të posaçme për nënshkrimin e kontratave të tilla.

Gjykata, duke vepruar sipas propozimit të palës paditëse si dhe duke marr për bazë edhe udhëzimet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë, për përcaktimin e lartësisë së kërkesës, ka bërë marrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmia financiare. Nga ekspertiza financiare e datës 28.02.2024, e punuar nga eksperti R.F., është konstatuar se qiraja sipas kontratës mes palëve për periudhën kohore prej 01.02.2001 e deri 30.04.2013 është në lartësi prej EUR 152,734.26.

Pas administrimit me provat e propozuara dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsyet si në vijim:

Për shkak të kohës së krijimit të raportit juridik mes palëve ndërgjyqëse, për vendosjen në këtë çështje kontestimore juridike, gjykata iu referuar Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare e ish RSFJ nr. 29 i datës 30 mars 1978 (tutje referuar si: “LMD”)

Sipas nenit 262.1 të LMD-së, *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Kurse sipas nenit 567.1 të të njëjtit ligj përcaktohet se *“Me kontratën e qirasë obligohet huadhënësi që ti dorëzojë sendin e caktuar qiramarrësit në përdorim, ndërsa ky obligohet t'i paguajë për këtë qiranë e caktuar”*. Në anën tjetër me nenin 583.1 të LMD-së, janë paraparë detyrimet e qiramarrësit, ku sipas kësaj dispozite përcaktohet se *“Qiramarrësi ka për detyrë ta paguajë qiranë në afatet e caktuara me kontratë ose me ligj e në mungesë të kontratës dhe të ligjit, ashtu sikundër praktikohet në vendin ku sendi i është dorëzuar qiramarrësit”*.

Bazuar në deklarinimet e palëve, provat e administruara në këtë çështje, e në veçanti nga kontrata mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës me numër të protokollit 09-70/2002, e lidhur me datë 01.02.2001, gjykata ka vërtetuar faktin se palët ndërgjyqëse kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, ku si qiradhënies në këtë çështje juridike është paditësi Komuna e Podujevës, ndërsa qiramarrës e paditura KEK. Sipas kësaj kontrate, palët janë pajtuar që këtu e paditura në emër të qirasë për shfrytëzimin kësaj pronë të paguaj shumën mujore prej 2,040.00 DM (marka gjermane). Ndërsa, mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se e paditura ka

shfrytëzuar pronën objekt të kësaj kontrate deri në vitin 2013, përkatësisht deri kur paditësi ka ushtruar padi për kompensimin në emër të qirasë.

Në këtë drejtim, duke qenë se gjykata ka vërtetuar ekzistimin e raportit juridik mes palëve ndërgjyqëse, ndërsa në anën tjetër e paditura nuk ka përmbushur obligimin e saj kontraktual, përkatësisht nuk ka paguar borxhin e krijuar në emër të qirasë për shfrytëzimin e pronës, rezulton se kërkesëpadia e paditësit është bazuar në nenin 262.1 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*, pasi që mes palëve është krijuar raporti detyrimor ku paditësi ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit.

Prandaj, duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e detyrimit i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitave të cekura si më lartë dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase kërkesa e paditësit për pagesën e qirasë për periudhën kohore prej datës 01.08.2010 e deri më 13.04.2013, në shumë të përgjithshme prej EUR 33,828.84, është e bazuar dhe nuk është përfshirë në parashkrim në kuptim të nenit 375 të LMD-së, ngase për asnjërën nga periudhat periodike mujore nuk kanë kaluar mbi tre vite nga arritja e secilës kërkesë për pagesë e deri në paraqitjen e padisë nga ana e paditësit, veprim ky i paditësit i cili ka pasur për pasojë ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit të kërkesave prej datës 01.08.2010, në kuptim të nenit 388 të LMD-së, sipas së cilit *“Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*.

Ndërsa, gjykata duke u mbështetur në nenin 375 të LMD-së, me të cilin parashihet se *“Kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shumë totale, parashkruhet për tre vjet”*, ka vendosur sikurse në pikën e II-të të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që të gjitha kërkesat e qirasë për periudhën kohore nga 01.02.2001 deri më 31.07.2010 janë përfshirë në parashkrim nga fakti se kanë kaluar më shumë se 3 vite për secilën kërkesë periodike të arritur për pagesë para datës 01.08.2010.

Gjykata pati parasysh pretendimet e të paditurës në raport me parashkrimin e vet të drejtës në kuptim të nënti 373 të LMD-së, nga fakti se në këtë çështje kemi të bëjmë me kërkesa nga viti 2001, ndërsa padia është paraqitur në vitin 2013, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase afatet e parashkrimit të kërkesave të cilat burojnë nga qiraja janë të rregulluara me dispozitat nga neni 375 të LMD-së, sipas së cilës dispozitë përcaktohet se *“Kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shumë totale, parashkruhet për tre vjet”*.

Poashtu, gjykata i gjeti si të pabazuara edhe pretendimet e të paditurës lidhur me palvefshmërinë e kontratës me pretendimin se e njëjta është nënshkruar nga punonjësi i paautorizuar, kjo pasi që, e paditura përkundër që në kuptim të nenit 319.1 të LPK-së ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon pretendimet e saj, nuk ka ofruar ansjë provë për të vërtetuar një fakt të tillë. Ndërsa, në anën tjetër gjykata vlerëson se edhe sikur pretendimet e të paditurës të ishin të qëndrueshme, e paditura me veprimet e saj, përkatësisht me hyrjen në posedim të pronës sipas kontratës në fjalë ka dhënë miratimin për lidhjen e kontratës, në kuptim të nenit 88 të LMD-së, *“Kontrata që lidhet prej ndonjë personi si i autorizuari në emër të tjetrit pa autorizimin e këtij, e obligon personin e përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar vetëm nëse ky e lejon kontratën më vonë”*, ndërsa një miratim i tillë ka për efekt konvalidimin e kontratës, rrjedhimisht konsiderohet se kontrata është lidhur në mënyrë të rregullt.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat e tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike kontestimore.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, dhe sipas kërkesës së palës e ka detyruar të paditurën që t’ia paguaj paditësit edhe normën e kamatës që nga data e parashtrimit të padisë, data 06.08.2013, e deri në pagesën definitive. Lartësia e kamatës në rastin konkret, i referohet shkallës së kamatës të cilën e paguajnë bankat afariste në Republikën e Kosovës, për mjetet e deponuara pa destinim dhe për periudhën kohore të deponimit, më shumë se për një vit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 dhe 452.2 të LPK-së, duke vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Numri i lëndës: 2023:247429
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05676572

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 868/23, datë 13.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.